

L I G J
Nr.7886, datë 8.12.1994

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7710, DATË 18.5.1993 “PËR NDIHMËN DHE PËRKUJDESJEN SHOQËRORE”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7710, datë 18.5.1993, në nenin 3, pika 13 ndryshohet si vijon:

“Termi “Me pafhtësi zhvillimi” përfshin gjithë personat që janë bërë të pafhtë përpara moshës 21 vjeç. Pafhtësia përcaktohet nga komisionet mjekësore përkatëse, veprimtaria e të cilave rregullohet me akte nënligjore”.

Neni 2

Në nenin 5, pika 1 ndryshohet si vijon:

“Ndihmë ekonomike mund t’u jepet familjeve që përkujdesen për një ose më shumë anëtarë të saj, të cilët janë:

- a) të verbër;
- b) të pafhtë mendorë;
- c) me pafhtësi të rëndë zhvillimi.

Periudha e përfitimit në këto raste përcaktohet nga komisionet mjekësore përkatëse.

d) person i pafhtë që nuk mund të kujdeset për vetveten dhe për pasojë ka nevojë për ndihmën e një personi tjetër, me kusht që këta të pafhtë të mos kenë të ardhura ose t’i kenë ato të pamjaftueshme dhe të mos jenë të vendosur në ndonjë institucion publik të përkujdesjes shoqërore. Periudha e përfitimit përcaktohet sipas rekomandimit të komisionit mjekësor nga këshilli i bashkisë ose i komunës”.

Neni 3

Neni 14 ndryshohet si vijon:

“1. Jetimët, të moshuarit dhe personat e pafhtë, pa asnjë të ardhur, pranohen pa pagesë në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore. Shteti mbulon shpenzimet e tyre të mbajtjes në institucion, si dhe një kuotë për shpenzime vetjake. Masa e kuotës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Të moshuarit me të ardhura që kërkojnë të vendosen në shtëpitë e të moshuarve, si dhe prindërit që për arsye të ndryshme kërkojnë të vendosin fëmijët në shtëpitë e foshnjës e të fëmijës, marrin pjesë në shpenzimet e nevojshme në raport me të ardhurat e tyre. Kriteret e pranimi dhe kontributi financiar për këto raste përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Personave që janë vendosur në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore, mund t’u përmirësohen kushtet e tyre kundrejt pagesës për shërbime suplementare”.

Neni 4

Në nenin 16, në pikën 1 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Këshilli i bashkisë ose i komunës, sipas kriterëve të vendosura me vendim të Këshillit të Ministrave, kur plotësohen kushtet, ka të drejtë t’i propozojë Ministrisë së Punës, Emigracionit,

Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë për ngritjen e institucioneve të shërbimit të përkujdesjes shoqërore në territorin e tij”.

Neni 5

Në nenin 17 shtohet pika “d” me këtë përmbajtje:

“d) Ngritja dhe ndjekja e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”.

Neni 6

Neni 18 ndryshohet si vijon:

“Çdo bashki ose komunë duhet të ketë një ose më shumë administratorë shoqërorë.

Administratori shoqëror ka për detyrë:

1. Të verifikojë dhe propozojë familjet që kanë nevojë të marrin ndihmë ekonomike.
2. Të mbështesë familjet që kanë persona me aftësi të kufizuara dhe individë me probleme të tjera sociale.

3. Të rekomandojë vendosjen e personave në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

4. Të përgatitë dhe ruajë dokumentacionin e plotë në përputhje me aktet nënligjore.

5. Të ruajë fshehtësinë e të dhënave të marra.

Administratori shoqëror ka të drejtë:

Të intervistojë gjithë anëtarët e familjes pretenduese për ndihmë ekonomike, duke u kërkuar të paraqiten në zyrën e tij ose me anën e vizitës në shtëpitë e tyre. Familja që refuzon një gjë të tillë, humbet të drejtën e përfitimit nga ky ligj”.

Neni 7

Nenet 19, 20 dhe 21 shfuqizohen.

Neni 8

Në nenin 22, pika 3 ndryshohet si vijon:

“Ministri i Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë krijon komisionin e vendosjes së personave me aftësi të kufizuara në institucionet përkatëse të përkujdesjes shoqërore të drejtuara në nivel qendror, sipas kritereve të miratuara prej tij”.

Neni 9

Në nenin 23 ndryshohet si vijon:

“Për plotësimin e detyrave që burojnë nga ky ligj, në Ministrinë e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë ngrihen dhe funksionojnë drejtoritë përkatëse të ndihmës ekonomike dhe përkujdesjes shoqërore”.

Neni 10

Në nenin 24 pika 3 të ndryshohet si vijon:

“3. Inspektorët kanë të drejtë:

a) Të kontrollojnë veprimtarinë e seksionit ose zyrës së ndihmës ekonomike dhe përkujdesjes shoqërore përkatësisht në bashki dhe komunë.

b) Të kërkojnë zbatimin e përpiktë të këtij ligji, vendimeve të Këshillit të Ministrave në zbatim të tij dhe në mënyrë të veçantë zbatimin e procedurës së dhënies së ndihmës ekonomike nga ana e këshillave të bashkive dhe komunave.

c) Të propozojnë kufizimin ose ndërprerjen e fondeve të ndihmës ekonomike nga Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë për rastet e shkeljeve të faktuara.

ç) Për të gjitha rastet e shkeljeve të vërejtura të njoftojnë kryetarët e bashkive ose të komunave

dhe Ministrinë e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve politikë. Çdo shkelje e këtij ligji dhe e akteve në zbatim të tij quhet kundërvajtje administrative në bazë të ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”.

d) Të urdhërojë administratorin shoqëror të dëmshpërblejë dëmet e shkaktuara prej tij.

dh) Masa e gjobës ndaj administratorit shoqëror për shkeljet e sipërpërmendura varion nga 50 për qind në 100 për qind të pagës së tij mujore, por jo më shumë se tri të tilla në vit”.

Neni 11

Në nenin 28 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Vendosja në institucionet e përkujdesjes shoqërore që janë në varësi të rrethit, bashkisë ose komunës bëhet në bazë të kriterëve që miratohen nga ministri i Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë”.

Neni 12

Në nenin 33, pika 2, pas fjalës “komunë” shtohet fjala “prefektura”.

Neni 13

Në nenin 34, në shkronjën “b” pas fjalëve “Përkujdesjes shoqërore” hiqen fjalët “dhe çerdheve të rrethit”.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.993, datë 22.12.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha